



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:121971

Datë: 26.04.2024

Numri i dokumentit: 05624411

Ac.nr.7806/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, kolegji në përbërje nga gjyqtari Besnik Bislimaj– kryetar i kolegjit dhe gjyqtarëve Faton Ademi dhe Hidajete Gashi Alaj, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike të paditësve S. M. dhe I. M., nga fshati R., Komuna e Rahovecit, të cilin e përfaqëson i autorizuari avokat D. M., nga Prizreni, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “Siguria”, me seli në Prishtinë, për kompensim e dëmit material dhe jomaterial, duke vendosur sipas ankesave të paditësve dhe të paditurës, të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1391/2020 të datës 10.06.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 22.04.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. PJESËRISHTË aprovohet ankesat e paditësve S. M. dhe I. M., që të dy nga fshati R., Komuna e Rahovecit dhe në tërësi refuzohet ankesa e të paditurës Kompania e Sigurimeve “Siguria”, me seli në Prishtinë dhe NDRYSHOHET pika I, II dhe III e aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1391/2020 të datës 10.06.2021, sa i përket dëmit jo material dhe material për ndihmën e personit të tretë dhe ushqim të përforcuar dhe çështja tani gjykohet si në vijim: DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve “Siguria” me seli në Prishtinë, që në emër të dëmit jo material, si pasojë e aksidentit të shkaktuar me datën 10.09.2020, paditësit:

S. M., t’ia kompensoj shumat si në vijim:

-Për dhimbje trupore shumën prej 1,400.00 euro.

-Për frikë të përjetuar shumën prej 1,200.00 Euro.

-Në emër të ushqimit të përforcuar shumën prej 150.00 euro. pjesa tjetër e kërkesë padisë së paditësit S. M. përtej shumave të gjykuara e deri në shumën e kërkuar, refuzohet në tërësi si e pa bazuar.

Paditësit: I. M., t'ia paguaj :

- Për dhimbje trupore shumë prej 1,400.00 euro.
- Për frikë të përjetuar shumë prej 1,250.00 Euro.
- Në emër të ndihmës dhe kujdesit të huaj shumë prej 150.00 euro.
- Në emër të ushqimit të përforcuar shumë prej 150.00 euro. pjesa tjetër e kërkesë padisë së paditësit I. M. përtej shumëve të gjykuara e deri në shumë e kërkuar, refuzohet në tërësi si e pa bazuar.

II. Pjesërisht refuzohet ankesa e paditësve S. M. dhe I. M., nga fshati R., Komuna e Rahovecit, ndërsa aktgjykimin të Gjykatës Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1391/2020 të datës 10.06.2021, në pikën II dhe III në lidhje me kamatën e gjykuar, pika IV sa i përket dëmit material për rehabilitim klimatik si dhe pika V e aktgjykimin të nakimuar, VËRTETOHEN

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e atakuar C.nr.1391/2020 të datës 10.06.2021, ka vendosur:

I. APROVOHET PJESËRISHT si e bazuar kërkesëpadia e paditësve S. M. dhe I. M. nga fshati R., Komuna e Rahovecit.

II. OBLIGOHET e paditura Kompania e Sigurimeve “Siguria” me seli në Prishtinë, që paditësit Sami Morina, në emër të dëmit material dhe atij jo material, t'ia kompensoj shumë si në vijim:
- për dhimbje fizike (trupore) duke përfshirë të gjitha llojet e intensitetit, shumë prej 500.00 euro; - për frikën e përjetuar duke përfshirë të gjitha llojet e intensitetit, shumë prej 300.00 euro, gjithsej shumë prej 800.00 Euro, me kamatë ligjore prej 8%, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi e gjerë në pagesën definitive, brenda afatit 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimin nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

III. OBLIGOHET e paditura Kompania e Sigurimeve “Siguria” me seli në Prishtinë, që paditësit Ismet Morina, në emër të dëmit material dhe atij jo material, t'ia kompensoj shumë si në vijim:-
për dhimbje fizike (trupore) duke përfshirë të gjitha llojet e intensitetit, shumë prej 500.00 euro; - për frikën e përjetuar duke përfshirë të gjitha llojet e intensitetit, shumë prej 300.00 euro, gjithsej shumë prej 800.00 euro, me kamatë ligjore prej 8%, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi e gjerë në pagesën definitive, brenda afatit 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimin nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

IV. REFUZOHET si e pabazuar, pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësve përtej shumëve të gjykuar për dëmin material dhe jo material të përshkruara sikurse në pikën II, III të këtij aktgjykimi për dhimbjet fizike dhe frikën përtej shumëve të gjykuar, si dhe për ndihmë dhe kujdes të huaj, në emër të ushqimit të përforcuar dhe në emër të rehabilitimit fizioterapeutik.

V. Detyrohet e paditura, që t'ia paguajë paditësve shpenzimet procedurale dhe atë shumën në lartësi prej 1,339.00 € (njëmijë e treqind e tridhjetë e nëntë euro), në afatin prej 15 ditësh pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.

Kundër këtij aktgjykimi, në afatin e paraparë ligjorë, ankesë kanë parashtruar Paditësit, për shkak të: shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, me propozim Gjykatës së Apelit që të aprovoj si të bazuar ankesën e paditësve dhe ta ndryshohet aktgjykimi i shkallës së parë ashtu që të aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesë padia e paditësve si e bazuar.

Kundër këtij aktgjykimi, në afatin e paraparë ligjorë, ankesë ka parashtruar edhe e paditura E paditura Kompania e Sigurimeve “Siguria”, me seli në Prishtinë, ka paraqitur ankesë për shkak të: shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatim të gabuar dhe jo të drejtë të gjendjes faktike, zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim Gjykatës së Apelit në Prishtinë, që të aprovohet ankesa si e bazuar dhe ta prishë aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe lëndën ta kthej në ri procedurë dhe ri vendosje.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesat e paditësve është pjesërisht e bazuar.

Ankesa e të paditurës është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësit S. M. dhe I. M., që të dy nga fshati R., Komuna e Rahovecit, me datë 28.09.2020, në gjykatën e shkallës së parë ka parashtruar padi kundër të paditurës, Kompania e Sigurimeve “Siguria” me seli në Prishtinë, për kompensim të dëmit material dhe jo material, të cilën kërkesë paditësit e kanë precizuar me parashtresën e datës 10.06.2021, të specifikuar si në precizim të kërkesës.

Gjykata e shkallës së parë, duke vepruar sipas padisë së paditësve, ka mbajtur shqyrtimin kryesore, pas deklarimit të palëve ndërgjyqëse, administrimit të provave, ka nxjerrë aktgjykimin e ankimuar C.nr. 1391/2020 datë 10.06.2021, me të cilin ka vendosur që të aprovohet pjesërisht kërkesëpadija e paditësve, duke vendosur me saktësisht si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të ankimuar, gjykata e shkallës së parë ndër të tjera ka theksuar se: Në mes të palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestuese baza e kërkesëpadiisë, por ishte kontestuese lartësia e kërkesëpadiisë, ashtu që për ta vërtetuar lartësinë e kërkesëpadiisë, gjykata ka caktuar ekspert nga lëmia e mjekësisë dhe makinerisë, ku ekspertizat mjekësore të punuara nga Dr. Sci. N. F. psikiatër dhe I. S. ortoped, të cilët në bazë të dokumentacioneve të ofruara, kanë dhënë mendimin profesional përmes ekspertizave të punuara me datë 20.04.2021 – Ekspertiza mjekoligjore psikiatrike dhe ekspertiza mjekësore për lëndime trupore të paditësve.

Më tej ka arsyetuar se: Gjykata e mori në tersi si të bazuar dhe ia dha besimin e plotë ekspertizës mjekoligjore psikiatrike të lartpërmendur, ngase ekspertiza përmban elementet e nevojshme të të dhënave mbi bazën e njohurive profesionale dhe arsye të mjaftueshme të cilat gjykata i vlerësoi si të drejta për vërtetimin e fakteve vendimtare në këtë çështje kontestimore. Ndërsa ekspertizës së ortopedit për konstatimin e lëndimeve trupore gjykata ia fali besimin pjesërisht në lidhje me dhimbjet fizike për të dy paditësit ndërsa sa i përket ndihmës se personit tjetër, ushqimit të përforcuar dhe rehabilitimi fizioterapeutik dhe klimaterik gjykata nuk ia falë besimin ngase eksperti nuk i ka arsyetuar konstatimet por vetëm i ka përshkruar pa ndonjë arsyetim se pse është e nevojshme ndihma e personit tjetër tek paditësi Ismet Morina, ushqimi i përforcuar dhe rehabilitimi klimaterik tek të dy paditësit. Mendimi i ekspertit për këtë pjesë ishte i mangët dhe i pa arsyetuar se mbi çfarë baze ka dhënë konstatimin e tij përveç shkresave mjekësore për të dy paditësit.

Më tej ka theksuar se: Me nenin 136 par. 1 të Ligjit për Marrëdhënia të Detyrimit (Nr. 04/L-077), është paraparë se: *"Kush i shkakton tjetrit dëmin ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij"*, ndërsa me nenin 137 të po këtij ligji është paraparë se: *"Dëmi është zvogëlim i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur), si dhe shkaktimi tjetrit i dhembjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jo material)"*. Në nenin 140 i cili përcaktohet që: *"Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje apo nga pakujdesia"*. Po ashtu me nenin 159 par.1 të LMD-së parashihet se: *"Në rast aksidenti të shkaktuar nga mjete motorik në lëvizje që është shkaktuar vetëm për faj të një zotëruesi, zbatohen rregullat për përgjegjësinë në bazë të fajit"* në nenin 174 i këtij ligji përcakton: *"Gjykata duke marr parasysh edhe rrethanat që janë shkaktuar pas shkaktimit të demit, do të gjykojë shpërblimin në një shumë e cila është e nevojshme që gjendja materiale e të dëmtuarit të sillet në atë gjendje në të cilën do të kishte qenë po të mos kishte veprim dëmtues"* kurse në nenin 179 par.1 të këtij ligji parashihet se: *"Kush i shkakton tjetrit lëndim trupor ose ia dëmton shëndetin ka për detyrë që ti shpërblejë shpenzimet rreth mjekimit dhe shpenzimet tjera të nevojshme lidhur me këtë, si dhe fitim e humbur për shkak të paaftësisë për punë gjatë kohës së mjekimit"*, ndërsa në par.2 të po këtij ligji parashihet se: *"Lartësia e shpërblimit të dëmit caktohet sipas çmimeve në kohën e nxjerrjes së vendimit gjyqësor, përveç nëse me ligj parashihet diçka tjetër"*. Po ashtu në nenin 183 par.1 të këtij ligji parashihet se: *"Për dhembjet e pësuar fizike, për dhembjet e pësuar shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, të shëmtimit, të cenimit të autoritetit, të nderit, të lirive ose të drejtave të personalitetit, të vdekjes së personit të afërm si dhe frikës, gjykata po të konstatojë se rrethanat e rastit, sidomos intensiteti i dhembjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e arsyetojnë këtë, do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla, pavarësisht nga shpërblimi i dëmit material si dhe nga mungesa e dëmit material"* ndërsa në par. 2 të po këtij neni është paraparë se: *"Me rastin e vendosjes për kërkesën për shpërblimin e dëmit jo material, si dhe për lartësinë e shpërblimit të tij, gjykata do të kujdeset për rëndësinë e cenimit të së mirës dhe të qëllimit të cilit i shërben ky shpërblim, por edhe për atë se me të mos favorizohen synimet që nuk janë në pajtim me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror"*. Po ashtu bazuar në nenin 10 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia (Ligji Nr.04/L-018), parasheh *"Kompensimi i dëmit material dhe jomaterial bëhet në pajtim me dispozitat e Ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve"*.

Më tej ka theksuar se: Duke u bazuar në dispozitat e cekura më lartë si dhe duke i vlerësuar të gjitha kriteret e dhe masat e caktimit e lartësisë së shpërblimit të dëmit material dhe jo material, e posaçërisht duke marrë parasysh natyrën dhe shkallën e dëmtimeve trupore që i janë shkaktuar paditësve, në bazë të vlerësimit të ekspertizës mjekësore të përshkuar si më lartë, gjykata e aprovoj pjesërisht kërkesëpadinë e paditësve në vlerat e shpërblimit të dëmit si në pikën I. II. dhe III. të dispozitivit të aktgjykimit, duke i vlerësuar si shpërblim real dhe objektiv dhe me bindje se këto shpërblime janë në pajtueshmëri me natyrën dhe pasojat e dëmit.

Më tej ka arsyetuar se: Gjykata konsideron se shumatat e gjykuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi paraqesin një satisfiksion moral dhe shpagim real për format e dëmit të pasuar të paditësve në aksidentin e komunikacionit, lëndimet dhe pasojat, duke marrë parasysh dhe kriteret e parapara me dispozitën e nenit 183 të LMD-së, standardin jetësor të qytetarëve të Kosovës dhe praktika e deritanishme të Gjykatave të Republikës së Kosovës. Lartësia e dëmit jo material është marrë për bazë në rrethanat e përcaktuara nga eksperti ortoped pjesërisht dhe ekspertit psikiatër në tërësi. Gjykata në lidhje me lartësinë e shpërblimit të dëmit ka marrë për bazë se lëndimet trupore të paditësve janë të natyrës së lehtë dhe intensiteti i dhimbjeve fizike nuk ka qenë i gjatë në kohë ndërsa në lidhje me përjetimin e frikës eksperti ka konstatuar se të dy paditësit kanë përjetuar frike sekondare ku edhe intensiteti i frikës nuk ka zgjatur shumë në kohë. Andaj gjykimi për dhimbjet fizike është marrë duke pasur parasysh praktikatat e shpërblimit të cilat aplikohen nga Gjykatat ndërsa sai përket frikës gjykata ka marrë lartësinë e shpërblimit simbolik pasi që frika në asnjë rast nuk mund të matet në sasi për këtë arsye u gjykua shuma simbolike e shpërblimit.

Më tej ka theksuar se: Gjykata vendosi si në pikën IV. të aktgjykimit, duke i refuzuar shumatat e aprovuara, ngase konsideroi se shumata e kërkuar mbi shumën e aprovuar është mbi shumën e cila nevojitet që gjendja materiale e të dëmtuarve të silltet aty ku do të ishte po mos të kishte ndodhur veprimi dëmtues. Mbi bazën e të lartcekurave, gjykata vlerëson se shumatat e kërkuara me kërkesëpadi përtej shumave të aprovuara, nuk janë reale dhe se të njëjtat nuk i përgjigjen shkallës së përgjegjësisë deliktore civile të të paditurës në lidhje me dhimbjet fizike dhe të frikës. Ndërsa ka refuzuar pjesën e kërkesëpadisë për sa i përket ndihmës se personit tjetër, ushqimit të përforcuar dhe rehabilitimi fizioterapeutik dhe klimaterik sepse paditësi si bartës i barrës së provës nuk ka propozuar prova me të cilat do të vërtetohej bazueshmëria dhe lartësia e dëmit në lidhje me këto forma të shpërblimit të dëmit.

Lidhur me kamatën e gjykuar, Gjykata e shkallës së parë ka vendosur në kuptim të nenit 382.2 të LMD-së.

Lidhur me shpenzimet e procedurës, ka vendosur konform nenit 452.2 të LPK-se.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi juridik i Gjykatës së shkallës së parë është pjesërisht i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që Aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkallë thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, drejtë dhe në mënyrë të plotë është vërtetuar gjendja faktike, mirëpo e drejta materiale pjesërisht është zbatuar në mënyrë të gabuar.

Gjithashtu aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të palëve ndërgjyqëse se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2 pika n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i Aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë dhe i ekzaminueshëm, e në përputhje të plotë me arsyet e Aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike i dispozitivit me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Po ashtu Gjykata e Apelit i vlerëson si të pa qëndrueshme pretendimet ankimore të palëve ndërgjyqëse në lidhje me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. pasi që nga provat që gjinden në shkresat e lëndës, të cilave dhe ja fali besimin e plotë edhe gjykatë së Apelit i rezulton e njëjta gjendje faktike e vërtetuar si ajo e gjykatës së shkallës së parë. pasi që pa mëdyshje është vërtetuar se ekziston përgjegjësia e të paditurës për kompensimin e dëmit të shkaktuar në aksidentin e trafikut të datës 10.09.2020, i cili dëm është shkaktuar me fajin e të siguruarit të të paditurës, fakt i cili nuk ka qenë kontestues në mesë palëve, pasi që e paditura vazhdimisht nuk e ka kontaktuar bazën juridike të kërkesë padisë së paditësve.

Gjykata e Apelit vlerëson se është zbatuar pjesërisht në mënyrë të gabuar e drejta materiale nga gjykata e shkallës së parë kur janë gjykuar shumat për demin jo material në emër të dhimbjeve fizike, frikës së përjetuar. Gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar dispozitën e nenit 183 të LMD-së. Pasi që për këto kategori të dëmit, për dhimbje fizike, për frikën e përjetuar janë shumë të ulëta ndërsa dhe nuk paraqesin kompensim realë për kompensimin e dëmit dhe as nuk janë në pajtueshmëri as me praktikën gjyqësore si dhe udhëzuesin e Gjykatës Supreme të Kosovës me nr. 41/2023 të datës 27.02.2023, pasi që të njëjtat shuma nuk paraqesin satisfaksion për të dëmtuarin e në rastin konkret për paditësit, prandaj gjykata e shkallës së dytë e aprovoi pjesërisht ankesën e paditësve, ndryshoi aktgjykimin e ankimuar pjesërisht për këto kategori të dëmit dhe gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke vlerësuar se shumat e aprovuara nga gjykata e shkallës së parë për format e kompensimit të dëmit jo material nuk bazohen në kriteret e zbatueshme për vlerësim, e as në praktikën gjyqësore të krijuar nga gjykatat e Kosovës për këto forma të shpërblimit të demit dhe as në natyrën dhe llojin e së mirës së dëmtuar.

Gjykata e Apelit, vlerëson se shuma e gjykuar si në dispozitivin nën I të e aktgjykimit të shkallës së dytë janë adekuate me kriteret dhe qëllimin e përcaktuar me nenin 183 të LMD, këto shuma përfaqësojnë një satisfaksion adekuat që të dëmtuarit ti përballojnë më lehtë dëmin jo materiale të pësuar, edhe pse kjo formë të dëmit nuk mund të vlerësohen e as të kompensohen me para. Me paragrafin 2 të nenit 183 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve përcaktohet se me rastin e vendosjes për kërkesën mbi kompensimin e dëmit jo material, si dhe mbi shumën e

kompensimit të tij, gjykata do të ketë parasysh rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe qëllimit të cilit i shërben ky kompensim, e gjithashtu edhe për faktin se të mos u shkojë përshtat synimeve që nuk janë të pajtueshme me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror”. Pra, nga interpretimi i kësaj dispozite ligjore rezulton se kompensimi duhet të jetë adekuat me natyrën e lëndimit, dhimbjeve fizike, frikën e përjetuar, ashtu që kompensimi të përfaqësojë një lehtësim në përballimin e tejkalimit të pasojave të dëmit. Shuma e gjykuar nga gjykata e shkallës së dytë si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi është reale dhe paraqet satisfakcion të vërtet dhe u shkojnë për shtati synimeve shoqërore për kompensimin e dëmit. Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes mori parasysh të gjitha rrethanat siç janë: natyrën e lëndimeve e cila është e lëndim i lehtë trupor, moshën e paditësve, intensitetin dhimbjeve dhe frikës së përjetuar, të konstatuara nga mendimi i ekspertëve Dr. Sci. N. F. psikiatër dhe I. S. ortoped, për të cilat ekspertiza palët ndërgjyqëse nuk kishin vërejtje si dhe praktikën gjyqësore të krijuar gjerë më tani e gjithashtu udhëzuesin e Gjykatës Supreme të Kosovës me nr. 41/2023 të datës 27.02.2023 sa i përket shpërblimit të dëmit për këto kategori të dëmit.

Gjykata e Apelit vlerëson se Gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të gabuar ka aplikuar të drejtën materiale kur ka refuzuar kërkesë padinë e paditësve në raport me dëmin material për ushqim të përforcuar si dhe ndihmën e personit të tretë, për paditësit, pasi që paditësit ju është shkaktuar ky lloje i dëmit dhe i njëjti është dashur që të merret si i mirëqenë pasi që për këtë kategori të dëmit edhe pse është dëme material, nuk ka nevojë të vërtetohej me prova konkrete pasi që është fakte i pa kontestuar se për paditësin I. M. në formë të ndihmës së personit të tretë është kujdesur familjari i tij dhe nuk mund të vërtetohet me prova konkrete e gjithashtu edhe për ushqimin e përforcuar paditësit kanë krijuar shpenzime për këtë kategori të dëmit. Andaj, gjykata e Apelit për këtë kategori të dëmit e ndryshoj aktgjykimin e ankimuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimit, pasi që vlerësoj se ky lloj kompensimi i gjykuar sipas këtij aktgjykimit është në harmoni me rrethanat e tjera të krijuara si dhe me vlerësimin e ekspertëve mjekësor, të cilët kanë konstatuar se për paditësin I. M. ka qenë e nevojshme ushqimi i përforcuar për 21 ditë, ndihma e personit të tretë në kohëzgjatje prej 15 ditë, ndërsa paditësi S. M. ka qenë e nevojshme ushqimi i përforcuar për 21 ditë dëme ky që është i mbështetur edhe në provat materiale që gjinden në shkresat e lëndës si dhe nevojat e paditësve të përcaktuara nga ekspertët e cekur si më lartë.

Gjykata e Apelit i vlerëson të pa bazuara pretendimet ankmiore të paditësit në lidhje me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale sa i përket kompensimit të dëmit material për rehabilitim klimatik për paditësit, ashtu që për këtë pjesë gjykata e Apelit pajtohet me qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, për faktin se paditësit nuk kanë ofruar asnjë provë mbi të cilat do të vërtetohet se dëmi është shkaktuar, kjo pasi që nuk mund të mjaftohet vetëm në konstatimet e ekspertit të ortopedisë i cili në ekspertizë ka konstatuar se paditësit kanë nevojë për rehabilitim klimatik, por të njëjtët nuk kanë ofruar provë materiale që vërtetojnë se të njëjtit kanë paguar mjete për rehabilitim dhe në këtë kuptim gjykata e Apelit vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Sa i përket vendimit për kamatën e gjykuar nga gjykata e shkallë së parë, edhe gjykata e Apelit e përkrah një vendim të tillë pasi që kamata e gjykuar është në pajtueshmëri të plotë me nenin 382 të LMD-së dhe se e njëjta do të filloj të rrjedhë nga dita e nxjerrjes së aktgjykimit të ankimuar.

Sa i përket vendimit për shpenzimet procedurale të gjykuara nga gjykata e shkallë së parë, edhe gjykata e Apelit e përkrah një vendim të tillë pasi që shpenzimet e aprovuara janë shpenzime në përputhshmëri të plotë me veprimet procedurale, e gjithashtu duke pas parasysh edhe suksesin e paditësit në procedurë dhe atë në kuptim të nenit 452.2 të LPK-së si dhe tarifën e Odës së Avokatëve të Kosovës.

Gjykata e Apelit i ka vlerësuar edhe pretendimet tjera ankimore, por gjeti se të njëjtat nuk kanë ndikim në vendosjen ndryshe në ankesat e paditësit dhe të paditurës.

Nga të cekurat u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në bazë të nenit 195.1 pika d) dhe e), të Ligjit nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.7806/2021, me datën 22.04.2024

Kryetari i kolegjit - gjyqtari,
Besnik Bislimaj, d.v